



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 157/6 prot.

Tiranë, më 17.03.2026

REKOMANDIM

Nr. 19, datë 27.03.2026

PËR KONTROLLUESIN “ALBANIAN TELECOMMUNICATION UNION”
SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Albanian Telecommunication Union” shpk (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 08, datë 15.01.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), me fokus masat teknike-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të të dhënave personale (PIMS).*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L01425001U me objekt aktiviteti: “Zhvillimin dhe funksionimin e telekomunikacioneve/elektronikës në përpunime me legjislacionin në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, etj.”

Albanian Telecommunications Union (ATU) është një kompani e specializuar në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit. Ajo ka në fokus furnizimin me internet,

transmetim të dhënash dhe shërbime “dark fibër”, duke operuar ekskluzivisht mbi një infrastrukturë me fibër optike. Klientët e saj janë operatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë ofruesit e shërbimeve internet (ISP) dhe bizneset që kërkojnë kapacitete të sigurta, të qëndrueshme dhe të shkallëzueshme rrjeti.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “klientë”, “vizitorë”, etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi grumbullon në arkivin fizik dokumentacionin për personelin aktual dhe të larguar. Nga verifikimi i dosjeve të vendosura në dispozicion, konstatohet se, në dosjet e personelit të larguar ruhen, ndër të tjera, kopje të: “vërtetim i gjendjes gjyqësore”; “certifikatë familjare”; “certifikatë notash”; “jetëshkrim”; “letërnjoftim” etj.

Nga analizimi i përmbajtjes së rregullores specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, të vendosur në dispozicion, rezulton se, Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të rishikojë dhe plotësojë rregulloren/dhe ose politikat e brendshme, duke përcaktuar në mënyrë të qartë, të argumentuar dhe të dokumentuar afatet e ruajtjes për çdo kategori të dhënash personale, duke marrë në konsideratë, qëllimin e përpunimit, bazën ligjore përkatëse; detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni sektorial, si dhe nevojën për ruajtje për qëllime të mbrojtjes së të drejtave ligjore apo për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Afatet duhet të jenë proporcionale dhe të justifikuar, duke shmangur ruajtjen e të dhënave për një kohë të pacaktuar.

Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të hartojë procedura të qarta për fshirjen, asgjësimin ose anonimizimin e të dhënave personale pas përfundimit të afatit të ruajtjes, si dhe mekanizma monitorimi dhe auditimi të brendshëm për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre afateve. Në rastet kur të dhënat ruhen për periudha më të gjata për qëllime arkivore në interes publik, për qëllime kërkimore apo statistikore, duhet të aplikohen masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar minimizimin e të dhënave dhe kufizimin e aksesit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

3. Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka publikuar “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të internetit www.atu.al, subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe

mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, faqja zyrtare e internetit përbën zakonisht pikën e parë të kontaktit ndërmjet Kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave, ndaj mungesa e një politike ose publikimi i saj në mënyrë jo të plotë i kufizon informacionin e nevojshëm të subjekteve mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

Gjithashtu, publikimi i *“Politikave të Privatësisë”* është thelbësor për ushtrimin efektiv të të drejtave të subjekteve të të dhënave. Vetëm përmes informimit të plotë sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit, subjektet e të dhënave mund të njihen me të drejtat e tyre dhe me mënyrën për t'i ushtruar ato, duke shmangur situatat ku këto të drejta mbeten formale dhe të pazbatueshme në praktikë. Njëkohësisht, ato shërbejnë si mjet parandalues ndaj praktikave jo ligjore ose të njëanshme të Kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se, Kontrolluesi disponon rregullorë *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*. Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj, si dhe nga analizimi në tërësi i provave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale të mbledhura, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale, konfidencialitetin, aksesin në të dhënat personale, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese që kryen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përshtatja dhe plotësimi i rregullores *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, me të gjithë elementët ligjorë të përcaktuar në pikën 1 të nenit 27 të Ligjit, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, në rregullore duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura organizative për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë fizike, teknike dhe administrative, ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave, aksesin, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave.

5. Kontrolluesi, gjatë hetimit administrativ, ka vendosur në dispozicion të grupit të kontrollit, kopje të Certifikatës së Konformitetit *“Për sistemin e menaxhimit të*

sigurisë së informacionit” ISO 27001:2022, për aktivitetet: “*Shërbime në fushën e infrastrukturës dhe telekomunikacionit, të transmetimit të të dhënave, të fibrës së zezë, aksesit të internetit të dedikuar, rrjeteve, sistemeve, dhe programeve kompjuterike, sigurisë së transmetimit dhe ruajtjes së informacionit, të shërbimit LAN/WAN, mirëmbajtjes së rrjeteve LAN/WAN. Transmetim të dhënash me Wireless dhe fibër optike*”. Megjithatë, rezulton se Kontrolluesi nuk dokumenton masat organizative dhe teknike të ndërmarra në kuadër të sigurisë së informacionit, gjatë ushtrimit të aktivitetit, veçanërisht nëpërmjet sistemeve elektronike sipas këtij standardi, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Konstatohet se, mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si: *pseudonimizimi dhe enkriptimi i të dhënave, kontrolli i aksesit dhe menaxhimi i identitetit, aftësitë për qëndrueshmëri dhe rivendosje të shpejtë të disponueshmërisë së shërbimeve, testime të vazhdueshme dhe vlerësime të masave të sigurisë, duke përfshirë simulime sulmesh dhe auditime sigurie për të garantuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe për të identifikuar vulnerabilitete që mund të përbëjnë rrezik për të dhënat, si dhe testime të rregullta për depërtime dhe vlerësime vulnerabiliteti, duke përfshirë implementimin e masave korrigjuese, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).*

Kuadri ligjor evropian (të cilin Ligji transponon) dhe praktika më e mirë evropiane, e konsideron certifikimin si një mekanizëm përputhshmërie me Ligjin¹ dhe për të inkurajuar zbatimin e tij, i krijon rast pas rasti kontrolluesve që e zbaton atë në mënyrë efektive, një pozitë preferenciale në kryerjen e disa veprimtarive përpunuese të caktuara siç janë për shembull transferimet ndërkombëtare.

Në zbatim të nenit 37 të Ligjit, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 8 datë 20.11.2025 të Komisionerit “Për kriteret shitesë për akreditimin e organizmave certifikues” (në vijim, “Udhëzimi nr. 8”) dhe Udhëzimin 9 datë 20.11.2025 “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale” (në vijim, “Udhëzimi nr. 09”).

Udhëzimi nr. 9 referon në Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*) dhe Komisioneri inkurajon kontrolluesit të cilët për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre e kanë të nevojshëm ngritjen e një sistemi të tillë me qëllim standardizimin dhe rregullimin e veprimtarisë përpunuese dhe garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatimin e Udhëzimit 8 dhe 9.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, duhet të krijojë,

¹ Pika 3 e nenit 22, pika 3 e nenit 28

mirëmbajë dhe administrojë një PIMS në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 13 të Udhëzimit nr. 09 dhe nenit 28 të Ligjit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm.

6. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 30 i Ligjit, si dhe Vendimi nr. 6 i Komisionerit. Megjithatë, Kontrolluesi pas marrjes dijeni për Urdhrin e hetimit administrativ, me datë 22.01.2026 ka aplikuar “*Deklaratën e Konfidencialitetit*” për disa punonjës të tij, të cilët janë të përfshirë në procese përpunuese.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është garantimi i ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë të çdo nëpunësi që ka akses në të dhëna personale, duke përcaktuar në mënyrë të qartë, kufijtë e përpunimit të lejuar, ndalimin e përdorimit të të dhënave për qëllime personale apo të paautorizuara, detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Ky instrument përbën një masë thelbësore organizative në kuadër të parimit të përgjegjshmërisë, duke dokumentuar faktin se Kontrolluesi ka marrë masa konkrete për të garantuar përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 30 të Ligjit.

7. Konstatohet se, aktivitetet kryesore të Kontrolluesit janë procese përpunimi, të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë. Kontrolluesi nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit. Megjithatë, pas marrjes dijeni për Urdhrin e hetimit administrativ, Kontrolluesi ka emëruar me deklaratën e datës 22.01.2026, nëpunësin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese, që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të publikuar të dhënat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji, si dhe për t’ia njoftuar ato Zyrës së Komisionerit.

8. Në kuadër të Vendimit nr. 151, datë 06.03.2025, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës on-line TIKTOK” (në vijim, “VKM nr. 151”), si dhe në zbatim të marrëveshjes së përbashkët midis Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare “Marrëveshje për instalimin e platformës së menaxhimit të aksesit në internet” (në vijim, “Marrëveshje”), pranë Kontrolluesit është implementuar në rrjetin e tij teknologjia Deep Packet Inspection (DPI).

Referuar pikës 3.3, të nenit 3 të Marrëveshjes, Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion protokolle të sigurisë për aksesin e personelit të Organit rregullator. Gjithashtu, rezulton se Kontrolluesi nuk aplikon kërkesat minimale të sigurisë sipas përcaktimeve të Shtojcës 4, të Aneksit 5 të kësaj Marrëveshje (pikat 1 -10), për ngritjen e mekanizmave të sigurisë së të dhënave, për sigurinë e integritetit, konfidencialitetit të të dhënave, planin e sigurisë, etj., në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 04.02.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë të cilës ka deklaruar angazhimin për rekuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, paraprakisht nga ana e Kontrolluesit, me shkresën nr. 004 prot., datë 02.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 157/5 prot., datë 2.2.2026, janë përcjellë me relacion shpjegues të gjitha masat e marra në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore, si dhe sqarimet lidhur me gjetjet e procesverbalit të hetimit administrativ si vijon:

- Lidhur me pikën 1 të procesverbalit, Kontrolluesi në mënyrë të përmbledhur bën me dije se është një organ që rregullohet dhe funksionon mbi bazën e legjislacionit për komunikimet elektronike dhe nuk afekton direkt Pajtimtarin (Klientin) fundor, por është një subjekt i lidhur B2B (Business to Business), pra marrëdhënie të karakterit tregtar midis kompanive, ku i ofrohet këtyre të fundit interneti dhe data (intranet), që këta të fundit ta rishesin te individët apo kompani të tjera. ATU informon se ofron vetëm fibrën e saj optike dhe nuk ka të dhëna të karakterit personal që mblidhen, ruhen dhe përpunohen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Kontrolluesi, si dhe nga verifikimet e kryera, është konstatuar se ATU kryen veprime të përpunimit të të dhënave personale, në kuptim të Ligjit. Këto të dhëna, ndonëse nuk administrohen dhe nuk ruhen në dosje të veçanta të strukturuar sipas kategorive apo qëllimeve të përpunimit, përbëjnë objekt përpunimi sipas Ligjit, pasi mblidhen, regjistrohen, përdoren dhe mbahen nga Kontrolluesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

- Lidhur me pikën 2 të procesverbalit, nga ana e Kontrolluesit argumentohet se në kontratën e punës që nënshkruhet nga punëmarrësit, neni 11 përcakton detyrimin e konfidencialitetit në zbatim të Kodit të Punës, si dhe në zbatim të legjislationit për mbrojtjen e të dhënave personale punëmarrësit pajisen me autorizimin përkatës përmes së cilit konfirmojnë pranimin dhe respektimin me rregullat për ruajtjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale gjatë gjithë periudhës së punësimit. Lidhur me afatin e mbajtjes së dokumentacionit, Kontrolluesi sqaron se i ruan dokumentet për një periudhë 6-mujore në referim të Kodit të Punës, si dhe çdo dokument tërhiqet nga punonjësit e larguar. Aktualisht vetëm dy punonjës nuk kanë tërhequr dokumentacionin.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Gjatë hetimit administrativ në terren dhe verifikimet e kryera në dosjet e mbajtura pranë zyrës së arkivit, rezulton se, Kontrolluesi mban dhe ruan në dosje, dokumente që përmbajnë të dhëna personale të punonjësve të larguar, përtej afatit 6-mujor të pretenduar. Lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5 të nenit 6, të Ligjit. Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

- Lidhur me pikat 5 dhe 8, Kontrolluesi argumenton se, është subjekt i licencuar me certifikatë ISO “Shërbime në fushën e infrastrukturës dhe telekomunikacionit, të transmetimit të të dhënave, në fibër: aksesin në internet të dedikuar, rrjeteve, sistemeve, dhe programeve kompjuterike, sigurisë së transmetimit dhe ruajtjes së informacionit, të shërbimit LAN/WAN, mirëmbajtjes së rrjeteve “LAN/WAN. Transmetim të dhënash me wireless dhe fibër optike”, këto elementë i ka detyrë bazike për shkak se kjo përcakton dhe sigurinë e rrjetit të saj në përputhje me Kreun XIX “Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia” të ligjit 54/2025 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, pasi është organ që ofron shërbime me kualitet të lartë dhe disponon bërthamën kryesore të rrjetit kryesor në Republikën e Shqipërisë. Lidhur me Marrëveshjen për instalimin e platformës së

menaxhimit të aksesit në internet, Kontrolluesi sqaron se ajo ishte e karakterit tip e ofruar ndaj gjithë operatorëve të telekomunikacionit që shesin me shumicë dhe aksesit ka qenë tepër i kufizuar.

Lidhur me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron. Kontrolluesi duhet të zbatojë masat e nevojshme tekniko-organizative të tilla si pseudonimizimi dhe enkriptimi, kontrolli i aksesit dhe menaxhimi i identitetit, aftësitë e qëndrueshmërisë dhe për të rivendosur disponueshmërinë, testime të vazhdueshme dhe vlerësim të masave të sigurisë, testime të rregullta për depërtime dhe vlerësime vulnerabiliteti duke përfshirë edhe masat korrigjuese. Në funksion të zbatimit të këtyre masave, Kontrolluesi ndërmerr veprime të dokumentuara me karakter parandalues që përfshijnë monitorimin e vazhdueshëm dhe evidentimin e parregullsive.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 27, 28, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjithë proceset e përpunimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për të publikuar rubrikën “*Politikat e Privatësisë*”, në faqen e internetit www.atu.al, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e rregullores “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit etj.;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;

5. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

- (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve detyrimin e përcaktuar në pikën 1 më sipër;
- (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 më sipër;
- (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 5 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;

7. Komisioneri, bazuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të mos zbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 27.03.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi